



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Sokol Haliti, Kryetar

Adresa: Rruga "28 Nëntori", Viti, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vitisë (Komuna e Vitisë), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Vitisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Vitisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komuna e Vitisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Për vëmendjen tuaj, dëshirojmë të theksojmë faktin se Komuna kishte bërë pagesa nga kategoria e Mallrave dhe shërbimeve në bazë të vendimeve gjyqësore, në shumën prej 46,615€ për kompensimin e pagave jubilarë, pagave përcjellëse dhe shpenzimeve tjera të procedurave gjyqësore. Shumat e paguara janë keq klasifikuar për shkak se nuk përkojnë me kategorinë adekuate të shpenzimeve, me ç'rast janë mbivlerësuar shpenzimet në kategorinë e Mallrave dhe shërbimeve dhe për të njëjtën shumë janë nënvlerësuar shpenzimet e pagave dhe meditjeve. Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Vitisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Vitisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Vitisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Vitisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Vitisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.


Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalljet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 5].

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 5].

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e planifikuara për vitin 2020 ishin 948,599€ ndërsa janë realizuar 623,749€. Ato kanë të bëjnë me të hyra tatimore (të hyrat nga tatimi në pronë) në vlerë prej 331,346€ dhe të hyra jo tatimore 292,403€ (të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga qiraja etj.). Komuna gjithashtu kishte edhe të hyra indirekte në vlerë prej 155,655€, prej tyre nga dënimet në trafik 146,046€, gjobat e gjykatave 5,250€ dhe gjobat nga Agjencia e Pyjeve 4,359€.

Çështja A1 - Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave

Gjetja Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha pronave brenda territorit të saj.

Komuna nuk ka arritur të kryej inspektimin minimal të pronave të paluajtshme prej 20% të të gjitha pronave. Nga 12,443 prona të evidentuara në bazën e të dhënave mbi tatimin në prone (këtu janë përfshirë edhe 128 prona të reja të regjistruara në vitin 2020), komuna kishte arritur të verifikoj 428 prej tyre apo vetëm 3%.

Kjo tregon një performancë të dobët në inspektimin e pronave të paluajtshme, por që ndikim në këtë proces kishte pasur Pandemia Covid-19 e cila ka kufizuar lëvizjet e zyrtarëve komunal në teren.

Ndikimi Inspektimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe komunalitë në vitin 2020 ishte 2,282,273€, prej tyre ishin shpenzuar 2,044,442€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime për shërbime të arsimit dhe trajnimeve, mirëmbajtje të rrugëve lokale, furnizime me dru për nxehje, mirëmbajtje të ndërtesave, furnizime mjekësore, shërbime tjera kontraktuese, pajisje, komunalitë etj. Kemi testuar 36 mostra për teste substanciale në vlerë 265,761€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Angazhimi për shërbime të veçanta pa kryer procedurat adekuate ligjore

Gjetja

Neni 84 i Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/L-114 thekson se - Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave të KRPP-së për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit

Komuna gjatë vitit 2020 kishte angazhuar 83 zyrtarë për shërbime të veçanta, për këto angazhime Komuna kishte zhvilluar procedurat të rekrutimit sipas Ligjit për Shërbimin Civil. Ne analizuam rastet e angazhimeve pas hyrjes në fuqi të ligjit për zyrtarët publik, dhe kemi vërejtur se në 49 raste të angazhimeve kontratat ishin nënshkruar pa udhëhequr ndonjë procedurë të prokurimit siç kërkohet me ligjin për zyrtarët publik.

Shumica e të angazhuarve me këto marrëveshje ishin për mbulimin e pozitave të rregullta, dhe sipas menaxhmentit kjo ishte pasojë e mungesës së pozitave të aprovuara në planifikimin e buxhetit.

Ndikimi

Anashkalimi i procedurave të prokurimit në lidhje me mbulimin e pozitave për shërbime të veçanta, përveç mosrespektimit të procedurave ligjore po ashtu e rrit edhe rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyrat e caktuara, çka mund të reflektoj edhe në performancë e tyre në punë.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbush detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.1.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Çështja A3 - Shpenzimet gjyqësore/përmbartimore për faturat e pa paguara

Gjetja Sipas nenit 39.1 të Ligjit nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kërkohet që secila faturë e vlefshme dhe kërkesa për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës; Neni 40 Pagesa bazuar në aktgjykimet e formës së prerë të gjykatës 40.1.

Komuna nuk ka paguar detyrimet e saj brenda periudhës së paraparë ligjrisht dhe kishte një trend në rritje të pagesave nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore-përmbartimore. Pagesat e realizuara nga thesari me vendime gjyqësore/ përmbartimore gjatë vitit 2020 ishin 204,755. Vlera e pagesave për mallra e shërbime ishte 58,998 kurse për investime kapitale ishte 145,757€ Prej tyre sipas raportit të pranuar nga ZKF borxhi kryesor ishte 164,029€ kurse shpenzimet procedurale të gjykatës (përmbartimit) ishin 40,725€.

Mos pagimi i faturave brenda afatit të përcaktuar ka sjellur te ekzekutimin e këtyre pagesave përmes procedurave gjyqësore. Kjo ishte për shkak të planifikimit të dobët nga komuna dhe dështimit për të siguruar fonde buxhetore për të paguar shpenzimet me kohë.

Ndikimi Mosplanifikimi adekuat i shpenzimeve dhe vonesat në ekzekutimin e pagesave kanë ndikuar që Komuna të paguaj shpenzime shtesë gjyqësore / përmbartimore për shërbimet / mallrat e blera. Pagesa të tilla përmes procedurave gjyqësore/ përmbartimore përveç që e dëmtojnë buxhetin, ati ndikojnë edhe në çrregullime të buxhetit të vitit vijues dhe në mos implementimin e projekteve të reja.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat të paguhen brenda afatit ligjor, dhe porositja e mallrave, punëve ose shërbimeve të bëhet vetëm kur Komuna siguron mjete të mjaftueshme buxhetore për pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera neto e pasurive kapitale e paraqitur në PFV është 83,340,789€, pasurive jokapitale është 240,988€, si dhe e stoqeve 5,153€. Kemi testuar 64 mostra për teste substanciale në vlerë 2,937,736€ si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë

Çështja B1 - Mos regjistrimi i të gjitha pasurive

Gjetja Sipas nenit 7 pika 2 të Rregullores MF 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore - kërkohet që regjistrimi i transakcioneve në regjistrat përkatës duhet të bazohet në dokumentet burimore që dëshmojnë se transakcioni ka ndodhur në përputhje me autorizimet përkatëse.

Po ashtu, neni 13 i rregullores sqaron rastin kur kemi blerje dhe ndërtim të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore ” Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit OB financuese do të mbyllë llogarinë e investimeve në vijim kurse OB pranuese pasurinë do ta regjistroj në regjistrat e saj”.

Katër shkolla të financuara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë(MASHT), të cilat komuna i shfrytëzon nga viti 2012, nuk ishin të regjistruara në regjistrin e pasurisë së Komunes në mungesë të dokumentacionit përcjellës. Transferimi i pasurisë nuk ishte bërë përkundër kërkesës së përsëritur nga Drejtori i Drejtorisë Komunale të arsimit (kërkesa fundit e datës 11.11.2020) për ofrimin e këtij dokumentacioni, MASHT-i ende nuk i është përgjigjur pozitivisht.

Kjo ka ndodhur për shkak se zyrtarët e Ministrisë së Arsimit nuk kanë dhënë asnjë përgjigje dhe arsye për mos dorëzimin e dokumentacionit përkatës.

Ndikimi Mungesa e dokumentacionit për pasurinë të cilën e shfrytëzon komuna, ndikon që të ketë të pamundur ta regjistroj këtë pasuri dhe rrjedhimisht kjo rezulton me një nënvlerësim të pasurisë komunale që e ka në shfrytëzim.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të ngris nivelin e komunikimit dhe të kontaktoj direkt Ministrin e MASHT-it për të mundësuar transferimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e shkollave në regjistrin e pasurive të komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.5 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,341,429€. Kjo vlerë përbehet nga Tatimi në pronë 1,983,125€, Taksat vjetore e biznesit 314,157€, Qeraja e hapësires publike 32,169€ dhe Shfrytëzimi i hapsirës publike - vendosja e reklamave 11,978€. Llogaritë e arkëtueshme të vitit 2020 në krahasim me vitin paraprak janë rritur për 265,758€.

Çështja A4 - Mungesa e angazhimit në arkëtimin e të hyrave nga qiraja

Gjetja Në nenin 3.4 te kontratat e nënshkruara për qera në mes Komunës dhe Bizneseve parashihet koha e pagesave. Afati i pagesave është paraparë të jetë në fillim të çdo muaji (data 01-05) për muajin paraprak.

Komuna e Vitisë kishte dhënë në shfrytëzim prona komunale me qera. Llogaritë e arkëtueshme nga këto prona të dhëna me qera janë në vlerë prej 32,169€. Ne testuam 6 mostra në vlerë totale 30,115€ dhe verifikuam se obligimi ekziston dhe se shumica janë të viteve paraprake. Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime ligjore për inkasimin e të arkëtueshmeve.

Mos aktiviteti i zyrtarve komunal dhe neglizhenca e tyre është shkaku kryesor për mos arkëtimin e të hyrave.

Ndikimi Mungesa e veprimeve konkrete për arkëtimin e të hyrave ndikon direkt në uljen e të hyrave dhe në mos realizimin e objektivave të planifikuara nga komuna si dhe rritë rrezikun që borgjet të vjetërohen duke u zvogluar gjasa e mbledhjes së tyre.

Rekomandimi A4 Kryetari përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të siguroj se janë duke u ndërmarrë veprime konkrete për inkasimin e të arkëtueshmeve nga qeraja e pronave komunale madje edhe duke aplikuar procedurat përmbareme dhe gjyqësore ndaj operatorëve që nuk përmbushin obligimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.6 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2020, ishte 418,348€, prej tyre 328,892€ për investime kapitale, 85,688€ për mallra dhe shërbime dhe komunalit si dhe 3,768€ për subvencione dhe transfere. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2021.

Çështja B2 - Vonesa në kryerjen e pagesave

Gjetja

Sipas nenit 37.1 të Rregullës Financiare 01/2013 të MF, përcaktohet se të gjitha faturat e pranuar nga organizata buxhetore duhet të paguhet brenda 30 ditësh, përveç nëse specifikohet ndryshe në kontratë.

Ne kemi vërejtur se në 6 raste në vlerë prej 218,495€, pagesa e faturave të pranuar nuk ishin bërë brenda 30 ditëve. Faturat e pranuar në nëntor dhe dhjetor 2020 janë paguar në fund të muajit Shkurt dhe Mars 2021. Vonesat e pagesave sillen nga 20 deri në 60 ditë.

Mos pagesa e faturave brenda periudhës së përcaktuar sipas menaxhmentit ka ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e pagesave mund të ndikojnë që Komuna të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbartimore për Komunën.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore, për të shmangur shpenzimet shtesë buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Ne identifikua se komuna në vitin 2020 ka mbetur pa zyrtarë të pasurisë pas pensionimit të zyrtarit aktual. Kjo çështje u diskutua me menaxhmentin dhe u zgjidh në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ajo nuk kërkon ndonjë veprim të mëtejshëm dhe raportohet vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit për në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre, si më poshtë:

Çështja 1

Mungesa e Zyrtarit për pasuri

Gjetja

Pas pensionimit të zyrtarit të pasurisë Komuna nuk kishte përzgjedhur zyrtarë për këtë pozitë. Kjo pozitë është e rëndësishme për komunën pasi Zyrtari i pasurisë ka përgjegjësi për evidentimin, përcjelljen dhe mirëmbajtjen e regjistrit të përgjithshëm të pasurive me të gjitha informatat që kërkohen për të gjithë pasurinë jofinanciare komunale.

Veprimi i kërkuar

Ne kemi udhëzuar Kryetarin që në afat sa më të shkurtër të caktoj një zyrtar për tu kujdesur për menaxhimin e pasurisë pasi pozita e Zyrtarit të pasurisë ka mbetur e zbrazët që një vit.

Rezultati

Lidhur me çështjen e ngritur nga ne për caktimin e zyrtarit të pasurisë jemi njoftuar se kryetari i Komunës me datë 12.04.2021 me vendim ka caktuar një zyrtarë të pasurisë, ku është bërë transfer i brendshëm dhe e kanë dërguar kërkesën në MF për trajnim dhe pritet të filloj trajnimin për certifikim.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	12,305,490.00	12,944,174.35	12,548,840.40	11,327,761.21	10,846,811.88
Grante Qeveritare - Buxheti	11,356,891.00	11,738,220.55	11,686,792.03	10,151,477.63	9,844,172.63
Financimi përmes huamarrjes	0.00	88,270.00	82,933.80	6,235.50	3,098.00
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	145,262.00	143,323.56	101,675.83	82,989.43
Të hyrat vetanake	948,599.00	948,599.00	613,442.31	999,349.25	689,682.74
Donacionet vendore	0.00	3,974.93	3,960.00	0.00	6,644.50
Donacionet e jashtme	0.00	19,847.87	18,388.70	69,023.00	220,224.58

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 638,684€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së buxhetit nga Granti qeveritar për 381,330€, Të hyrave të bartura nga vitet paraprake 145,262€, Huamarrjes prej 88,270€, donacioneve të jashtme prej 19,848€ dhe Participimeve nga banoret 3,974€.

Në vitin 2020 Komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit përfundimtar ose €12,548,840, me një ulje prej 2% në krahasim me vitin 2019. Sidoqoftë zbatimi i buxhetit ishte në një nivel të kënaqshëm.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	12,305,490.00	12,944,174.35	12,548,840.40	11,327,761.21	10,846,811.88
Pagat dhe mëditjet	7,387,753.00	7,576,505.72	7,575,623.82	7,295,880.63	7,142,576.47
Mallrat dhe shërbimet	1,631,703.00	1,978,272.83	1,740,444.65	1,383,762.39	1,063,318.00
Komunalitë	279,000.00	304,000.00	303,996.79	220,631.37	198,831.85
Subvencionet dhe transferet	250,000.00	351,733.38	251,600.26	211,322.50	260,486.45
Investimet Kapitale	1,660,150.00	2,733,662.42	2,677,174.88	2,216,164.32	2,181,599.11
Rezervat	1,096,884.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me atë fillestar është për 188,753€ më i lartë. Kjo rritje e bugjetit është nga granti qeveritar 111,365€, huaja për 74,970€ dhe donacionet 2,418€. Buxheti për paga është shpenzuar pothuajse në tërësi;
- Buxhetin final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 346,570€, kjo rritje është si rezultat i ndarjes së fondit nga granti qeveritar në vlerën 315,967€ me qëllim të menxhimit të pandemisë Covid-19, si dhe donacioneve të jashtme 17,425€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar në vlerë 7,858€ dhe nga huaja 5,320€. Ky buxhet është shpenzuar 88%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar është rritur për 101,733€ dhe atë nga granti qeveritar 85,000€, nga të hyrat vetanake të bartura nga viti paraprak 12,759€ dhe nga donacionet e jashtme 3,974€. Ky buxhet është shpenzuar 72%;
- Buxheti final për investime kapitale ishte rritur për 1,073,512€. Kjo rritje është si rezultat grantit qeveritar prej 940,887€, bartjes së të hyrave vetanake nga viti paraprak prej 124,645€ dhe nga huaja 7,980€. Ky buxhet është shpenzuar 98%. Në shpenzimin kaq të lartë të buxhetit ka ndikuar edhe pagesa e obligimeve nga vitet e kaluara në shumën prej 145,757€ përmes pagesave direkte nga Thesari;
- gjithashtu komuna për menaxhimin e pandemisë COVID-19 kishte shpenzuar 633,156€, prej tyre 261,397€ shtesa në paga, 286,759€ mallra dhe shërbime si dhe 85,000€ subvencione dhe transfere.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Shpenzimet në tri vitet e fundit kanë pasur një rritje të dukshme nga viti në vit, ku shpenzimet e vitit 2020 ishin më të larta se sa në vitin 2019 për 1,221,079€, ndërsa ato të vitit 2019 ishin më të larta se sa në vitin 2018 për 480,949€

Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Shpenzimet sipas kategorive përbëhen nga gati 2/3 apo 60.37% paga dhe mëditje, 21.33% investime kapitale, 13.87% mallra dhe shërbime, 2.42% komunalitë, dhe subvencionet marrin pjesë me 2%.

Të hyrat e planifikuara për vitin 2020 ishin 948,599€ ndërsa janë realizuar 623,749€. Ato kanë të bëjnë me të hyra tatimore (tatimi në pronë) 331,346€ dhe të hyra jo tatimore 292,403€ (lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.).

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	948,599.00	948,599.00	623,749.14	963,307.53	694,569.73
Të hyrat tatimore	491,074.00	491,074.00	331,345.81	434,109.17	329,525.20
Të hyrat jo tatimore	457,525.00	457,525.00	292,403.33	507,378.03	365,044.53
Të hyrat tjera	0.00	0.00		21,820.33	

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2019 të Komunës ka rezultuar me pesë rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Komuna nuk ka mbajtur ndonjë diskutim publik për gjetjet dhe rekomandimet e auditimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, një rekomandim është zbatuar dy rekomandime janë mbyllur dhe dy nuk janë zbatuar ende. Ecuria e zbatimit të rekomandimeve është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinin të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Ka pasur edhe këtë vit keqklasifikime por ky rekomandim është mbyllur pasi këtë çështje e kemi trajtuar tek pjesa e opinionit të auditimit si theksim i çështjes.	Nuk është i aplikueshëm më

2.	Të hyrat	Të hyrat Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se dhënia e pronës komunale në shfrytëzim të kryhet sipas procedurave të parapara ligjore.	Rekomandimi është mbyllur si i pa zbatuar për këtë rast, megjithëse raste të tjera të tilla këtë vit nuk kemi hasur.	Nuk është i aplikueshëm më
3.	Pasuritë	Pasuritë Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurohet se po ndërmerren hapat konkret për ofrimin e dokumentacionit burimor nga MASHT-i, në rastet kur nuk merren informacionet atëherë të bëjë vlerësimin e pasurisë dhe të dokumentohet me dëshmi përkatëse regjistrimi.	Rekomandimi nuk është zbatuar nga menagjmenti megjithëse Transferimi i pasurisë nuk ishte bërë përkundër kërkesës së nga Drejtori i Drejtorisë Komunale të arsimit për ofrimin e dokumentacionit nga, MASH, prandaj ky rekomandim përsëritet.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Obligimet e papaguara	Detyrimet Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore.	Rekomandimi nuk është zbatuar nga menagjmenti dhe edhe në fund të vitit 2020 niveli i faturave të pa paguara ishte i lartë, prandaj ky rekomandim përsëritet.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Auditimi i Brendshëm	Rekomandimi B4 Kryetari duhet marr të gjitha veprimet ndaj njësisve administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar	Rekomandimi është zbatuar pasi që nga 20 rekomandime të dhëna në vitin 2020 7 ishin zbatuar, 10 ishin në proces të zbatimit dhe 3 nuk ishin adresuar ende. Do të thot shumica e tyre janë trajtuar nga menaxhmenti.	I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetariduhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbush detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.
3.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat të paguhen brenda afatit ligjor, dhe porositja e mallrave, punëve ose shërbimeve të bëhet vetëm kur Komuna siguron mjete të mjaftueshme buxhetore për pagesa.
4.	Pasuritë	Kryetari të sigurohet se po ndërmerren hapat konkret për ofrimin e dokumentacionit burimor nga MASHT-i, në rastet kur nuk merren informacionet atëherë të bëjë vlerësimin e pasurisë dhe të dokumentohet me dëshmi përkatëse regjistrimi i pasurisë.
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të siguroj se janë duke u ndërmarrë veprime konkrete për inkasimin e të arkëtueshmeve nga qiraja e pronave komunale madje edhe duke aplikuar procedurat përmbartimore dhe gjyqësore ndaj operatorëve që nuk përmbushin obligimet.
6.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Udhëheqës i Auditimit



Xhevat Seferi, Udhëheqës i ekipit



Faik Thaqi, Anëtar i ekipit



Nebojsa Ristić, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit


Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
<p>Komuna gjatë vitit 2020 kishte angazhuar 83 zyrtarë për shërbime të veçanta, për këto angazhime Komuna kishte zhvilluar procedurat të rekrutimit sipas Ligjit për Shërbimin Civil. Ne analizuam rastet e angazhimeve pas hyrjes në fuqi të ligjit për zyrtarët publik, dhe kemi vërejtur se në 49 raste të angazhimeve kontratat ishin nënshkruar pa udhëhequr ndonjë procedurë të prokurimit siç kërkohet me ligjin për zyrtarët publik.</p>	<p>Lidhur me konstatimin e gjendjes pran Njesisë së Burimeve Njerzore nga ana e zyres Kombëtare të Auditimit e cila ka audituar procedurat e rekrutimit për vitin 2020 .</p> <p>Pas auditimit nga ana e juaj janë konstatuar të gjeturat lidhur me këto procedura sipas jush për vitin 2020 Komuna ka angazhuar 83 zyrtar për shërbime të veqanta sipas Ligjit mbi Shërbimin Civil bazuar në këtë është konstatuar se 50 raste të angazhimit me kontrata ishin nënshkruar pa udhëhequr procedur të prokurimit bazuar në Ligjin mbi zyrtaret publik .</p> <p>Njësia e Burimeve Njerzore konstatimin e juaj mbi të gjeturat e konteston në tërsi të pa bazuar për faktin se kjo njësi ka udhëhequr procedurat e rekrutimit sipas Ligjit mbi Shërbimin Civil neni 12 dhe Rregullores 02/2012 për procedurat e rekrutimit me marveshje të veqanta shih konkursin publik 20/01/2020 i cili është shpallur konform Ligjit për Shërbimin Civil e jo sipas Ligjit për Zyrtaret Publik sepse ndaj këtij Ligji është vendosur masa e përkoshme e Gjykatës Kushtetuese Nr.Ko/2019/19 i cili Ligj ka qenë i pezulluar deri me 10/11/2020 ku ne nuk kemi pasur të drejt të procedojm sipas këtij ligji të pezulluar nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në Ligjin mbi Shërbimin Civil neni 12 ku parashihet pranimi me</p>	<p>Komenti juaj nuk qëndron për faktin se ligji për zyrtarët publik 06/L-114 ka qenë i pezulluar deri më 13.07.2020 e jo siç e keni cekur në koment datën 10.11.2020. (Shih aktvendimin e Gjykatës kushtetuese në rastin KO 203/19 nr. i AGJ 1583/20) të datës 13.07.2020 në web - faqen e tyre.</p> <p>Vlerësimi ynë është bërë për kontratat e lidhura pas aktvendimit me të cilën ka përfunduar masa e pezullimit. Për më tutje neni 84 i këtij ligji nuk ka qenë i kontestuar nga palët e interesit. Me këtë mbetet konstatimi në raport dhe presim zbatimin e rekomandimit.</p>

marveshje të veqanta me konkurs kemi rekrutuar zyrtar deri me 30-06-2020 ku sipas Ligjit parashihet një kontratë deri në 6 muaj. Për puntorët teknik dhe fizik për të cilët kanë pasur nevoj drejtorit përkatëse është zhvilluar procedura e regutimit sipas Ligjit të punes nr 03/L-212 dhe Udhzimit Administrativ Nr 14/2011 për procedurat per rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënjes së punës në sektorin publik. Shih konkurset në web faqen e komunes së Vitisë :
 Nr 02/111/01/06 e dates 10/01/2020 dhe
 Nr 02/111/01/1026 e dates 23/10/2020

Leter Konfirmimi



Komuna e Vitisë



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Vitisë, për vitin 2020 .
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet e auditorit (përveq në Çështjen A2 kemi një koment nga zyra e personelit) dhe nuk kemi komente tjera për përmbajtjen e Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vitisë për vitin 2020.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzohet një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z.Kryetari i Komunës - Sokol Haliti

Data: 06. 07. 2021

Raporti Final serbisht



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁷ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.